

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit shtator, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 4 mbledhje, që kanë rezultuar në 17 vendimmarrje, ndër të cilat:

- Licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërive "MAGNA SOLAR POWER" shpk dhe "HPG ENERGY" shpk. Të dy këto shoqëri do të ushtrojnë veprimtarinë e licensuar për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet fotovoltaik me kapacitet të instaluar respektivisht 2 MW në Qarkun Fier, për një afat 30-vjeçar duke filluar nga data 12.09.2024, për shoqërinë "MAGNA SOLAR POËER" shpk dhe nga data 16.10.2024 për shoqërinë "HPG ENERGY" shpk.
- Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive:
 - "PARISOL" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Qarkun Fier.
 - "REBESOL" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Qarkun Fier.
 - "SAMASOL" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Qarkun Fier.
 - "ZENINA" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Qarkun Fier.

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Rinovime të licencave

Tarifa dhe çmime

Plotësim të kushteve

Aktivitete

Aplikime

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Vendime të tjera mbi të licencuar apo subjekte që kanë nisur aplikimin për licencim:

- Mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si rezultat i faktit që nuk është kryer pagesa e aplikimit / nuk janë plotësuar të gjitha kushtet sa përcaktuar në rregulloren e licencimit.
- Rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.pk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 07, datë 02.02.2015, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 20.12.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2025.
- Zgjatjen deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “BMG ENERGY SAL” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Pranimin e kërkesës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. dhe fillimin e procedurës për rinovimin e licencës veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 35, datë 04.03.2015 dhe rinovuar në vijim me vendimin nr. 159, datë 29.10.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 06.03.2025.
- Pranimin e kërkesës së shoqërisë “AYEN AS ENERGJI” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës dhe barrës siguruuese të radhës së dytë) mbi asetet e paluajtshme të saj, si dhe për vendosjen e barrës siguruuese të radhës së dytë mbi 90% të aksioneve të shoqërisë si mjete për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale.
- Ndryshimin e pikave 3 dhe 4 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 175, datë 04.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “TIRANA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW, i ndryshuar, sipas të cilave shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor brenda datës 17.07.2029 për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaiq “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” shpk, gjatë periudhës 01 – 31 korrik 2024, për sasinë 15,709 MWh, e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

- ERE është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjive të tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në analizat e saj propozon përmirësime të metodologjive ekzistuese.
- Sa i përket kësaj fushe përgjegjësie, gjatë muajit shtator janë marrë vendime mbi:
 - Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2024 prej 18.01 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Vendime të tjera si:

- Pranimi i kërkesës së shoqërisë OST sh.a. dhe fillimin e procedurës për shqyrtimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën rregullatore 2025-2027.[ES1]
- Mbi një ndryshim në Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike për operimin deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në aneksin a të licencës për prodhimin e energjisë elektrike të të licencuarve në këtë veprimtari, që duan të ushtrojnë të drejtën e dhënë nga kjo licencë për të operuar deri në 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar, me kusht që të njoftojnë menjëherë ERE-n mbi ndryshimet përkatëse.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Takimet në Vienë të Grupit të Punës së Gazit Natyror

Komisioneri z. Maksim Shuli së bashku me Drejtorin e Drejtorisë së Gazit Natyror, z. Gert Bitri, morën pjesë në takime të njëpasnjëshme të zhvilluara në Vienë, Austri, në datat 16, 17 dhe 18 shtator, të organizuar nga Agjencia Europiane e Bashkëpunimit të Rregullatorëve të Energjisë dhe Forumi i 19 i Gazit Natyror i organizuar nga Sekretariati i Energjisë.

Këto takime kishin për qëllim diskutimin e grupeve të punës për gazin natyror mbi ecurinë e Iniciativës Rajonale të Gazit, përmirësimin e kornizave rregullatore në këtë sektor, rritjen e transparencës si dhe përmirësimet e nevojshme në infrastrukturë dhe bashkëpunimit të mëtejshëm për të bërë të mundur ecurinë positive të Gazsjellësit Transballkanik në vitet e ardhshme.

Konferenca "Advancing Connectivity"

U zhvillua në Romë më 24 dhe 25 shtator, Konferenca "Advancing Connectivity: Nxitja e kapaciteteve të ndërlidhjes dhe integrimi në BE i partneritetit lindor" organizuar nga Këshilli i Rregullatorëve Evropianë të Energjisë (CEER) si pjesë e projektit të financuar nga BE-ja #EU4Energy.

Aktiviteti synon të mbështesë angazhimin e Bashkimit Evropian për rritjen e integritetit brenda dhe jashtë kufijve të tij, dhe promovon dialogun midis institucioneve evropiane, politikëbërësve, rregullatorëve dhe ekspertëve për të lehtësuar ndarjen e praktikave më të mira. Z. Elton B. Radheshi, Sekretar i Përgjithshëm në ERE, ishte pjesë e panelit të ekspertëve në Konferencë.



Vizita në Gestore del Mercato dhe seminari i 7-të i Shkollës Ballkanike të Energjisë



Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti së bashku me komisionerët e Bordit të ERE-s znj. Erjola Sadushi, znj Brunilda Tavani, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm z. Elton B. Radheshi dhe Drejtorin e Drejtorisë Juridike dhe të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, z. Denis Rushaj, morën pjesën në takim të organizuar me ftesë të GME (Gestore del Mercato) Itali dhe në seminarin e 7-të të Shkollës Ballkanike të Energjisë. Takimi u zhvillua datë 23 shtator në Romë, në kuadër të projektit KEP "Mbështetja e Autoritetit Rregullativ Shqiptar për të përmirësuar eficientësinë e tregut me shumicë të energjisë elektrike"

ERE është bashkëthemeluese e Shkollës Ballkanike të Energjisë, e cila ka synim të promovojë shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira, përfundimin e njohurive të vlefshme për sfidat dhe mundësitë që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës ndërkufitare.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Takimi me Institucionet e Pavarura në Kuvend

Gjatë takimit të përvitshëm me Institucionet e Pavarura, organizuar nga Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali, z. Petrit Ahmeti Kryetar i ERE-s gjatë fjalës së tij u shpreh shkurtimisht mbi arritjet e sektorit të energjisë, duke theksuar që sot Shqipëria ka për synim



kryesor përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe pse jo, të jetë vend eksportues i Energjisë elektrike në një të ardhme të afërt.

Z. Ahmeti gjithashtu i kushtoi rëndësi takimeve të herë pas hershme, të cilat mund të jenë frytdhënëse dhe pozitive me Kuvendin apo dhe Komisionet e përhershme të tij.

Të tjera

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), të [garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave të rifreskuar](#), si dhe [tarifa dhe çmime të miratuara nga ERE](#).

ERE ka nisur shqyrtimin e [kërkesës së OST sh.a. për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2025 – 2027](#).

Gjithashtu ju ftojmë të shfletoni të dhënat e fundit të tregut të energjisë në vend, ku do të gjeni [raporte periodike mbi monitorimin e tregut të energjisë dhe aktivitetin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike për 6-mujorin e parë të vitit 2024](#) si dhe [të dhënat e tregut të energjisë për 8-mujorin e vitit 2024](#).